



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 05.09.2016

Ref.: 779/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

V E N D I M

I. Riakreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji "Fama" për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Ekonomi, BA, 180 ECTS, (me specializime: Banka Financa dhe Kontabilitet; Menaxhment), (maksimum 360 student për vit akademik), Prishtinë, Gjiilan, Mitrovicë, Prizren;
- Banka, Financa dhe Kontabilitet, MA, 120 ECTS, (maksimum 50 student për vit akademik);
- Menaxhment, MA, 120 ECTS, (maksimum 60 student për vit akademik);
- Shkenca Politike dhe Administratë Publike, BA, 180 ECTS, (maksimum 80 student për vit akademik);
- Juridik, LLB, 240 ECTS, (Civil-Komercial; Penal-Kriminalistikë), (maksimum 330 student për vit akademik), Prishtinë, Gjiilan, Mitrovicë, Prizren;
- Psikologji, BA, 180 ECTS, (maksimum 340 student për vit akademik), Prishtinë, Gjiilan, Mitrovicë, Prizren;
- Psikologji, MA, 120 ECTS, (maksimum 50 student për vit akademik).

II. Akreditohen programet e studimit për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Infermieri, BSc, 180 ECTS, (maksimum 50 student për vit akademik);
- Mami, BSc, 180 ECTS, (maksimum 50 student për vit akademik).

III. Nuk ri/akreditohet programi i studimit:

- Studimet e Shkencave të Sigurisë, MA, 120 ECTS.

IV. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.

V. Obligohet BPrAL Kolegji "Fama" që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

VI. Obligohet BPrAL Kolegji "Fama" që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji "Fama" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim dhe akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Ekonomi, (me specializime: Banka Financa dhe Kontabilitet; Menaxhment)	BA	180	Fahruk Ahmeti, Raif Bytyqi, Ilmi Hoxha
2	Banka, Financa dhe Kontabilitet	MA	120	Rufi Osmani, Isuf Ahmeti, Bedri Ademi
3	Menaxhment	MA	120	Bedri Drini, Lumnije Thaçi, Venet Shala
4	Shkenca Politike dhe Administratë Publike	BA	180	Avdi Smajlaj, Eqrem Zenelaj, Zeqirja Idrizi
5	Juridik, LLB, 240 ECTS	LLB	240	Avdullah Robaj, Dashmir Idrizi, Natasha Shehu
6	Psikologji	BA	180	Arafat Shabani, Bunjamin Memedi, Ismet Bujupaj
7	Psikologji	MA	120	Qufli Osmani, Shaip Kabashi, Veton Latifi
8	Infermieri	BSc		/
9	Mami	BSc		/
10	Studimet e Shkencave te Sigurisë	MA		Abaz Lleshi, Frasher Demaj, Teki Kurti

AKA ka organizuar vizitën në BPrAL Kolegji "FAMA" më 22.08.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Reinhard Meyers; Prof. Dr. Danica Zeleznik; Prof. Dr. Ingeborg Mottl; Prof. Dr. Nevenka Čavlek; Prof. Dr. Robert Masten.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25 Gusht 2016 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "Fama", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Studimet e Shkencave të Sigurisë, MA, 120 ECTS raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Bazuar në Raportin e Ekspertëve, programi i propozuar nga Kolegji FAMA përmban mangësi për sa i përket strukturës së programit. Sipas ekspertëve, në aspektin përmbajtësor, programi i studimit reflekton zhvillimin e studimeve të konflikteve deri në vitet e 1990 dhe se ndryshimet e fundit në natyrën dhe formën e studimeve të konflikteve, të kuptuarit e sigurisë dhe zhvillimin e skenarëve të rinj kërcënues, janë marrë shumë pak parasysh nga institucioni. Po ashtu, sipas ekspertëve situata me stafin akademik tek Kolegji FAMA është mjaft konfuze për tu kuptuar. Sipas gjetjeve të ekspertëve, me një përjashtim gjithë stafi i propozuar nga institucioni nuk janë profesorë të fushës për programin e propozuar, mirëpo ata i takojnë fushës së historisë, juridikut, psikologjisë, shkencës politike. Meqenëse ndryshimet të cilat kërkohen për tu bërë në kurrikulën e programit janë të mëdha, Ekipi i Ekspertëve nuk rekomandon dhënien e ri/akreditimit për programin e studimit në fjalë, mirëpo fton Kolegjin FAMA të përgatis një aplikacion të ri në bazën e komenteve të dhëna në Raport.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Fama"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë